



HEPATITI B

TESTOHUNI. VAKSINOHUNI.





Tabela e përmbajtjes

Hepatiti B (Hep B) dhe mëlçia juaj | 1

Testohuni: Mësoni gjendjen tuaj lidhur me hepatitin B | 5

Vaksinohuni: Mbroni veten dhe të tjerët | 8

Merrni kujdes dhe trajtim | 8

Të jetuarit me hepatit B | 10

Shtatzënia, fëmijët dhe hepatiti B | 14

Informacione dhe burime | 16

Hepatiti B (Hep B) dhe mëlçia juaj

Hepatiti do të thotë inflamacion i mëlçisë. Mëlçia e mbron shëndetin tuaj në shumë mënyra. Ajo largon toksinat nga trupi dhe shndërron në energji lëndët ushqyese që merren nga ushqimi.

Hepatiti B mund të shkaktojë probleme të rënda shëndetësore, duke përfshirë çikatrizimin e mëlçisë, insuficiencën e mëlçisë, kancerin e mëlçisë dhe vdekjen e parakohshme. Ka disa lloje të ndryshme hepatiti. Hepatiti B shkaktohet nga virusi i hepatitit B, i cili infekton dhe sulmon mëlçinë.

Hepatiti B mund të parandalohet me anë të një vaksine të sigurt dhe mund të trajtohet për të ngadalësuar ose ndaluar dëmtimin e rëndë të mëlçisë. Personat që jetojnë me hepatit B mund të kenë një jetë të gjatë dhe të shëndetshme.



241 000 njerëz në qytetin e Nju-Jorkut (NYC) jetojnë me hepatit B.



2,2 milionë njerëz në Shtetet e Bashkuara të Amerikës jetojnë me hepatit B.

Si mund të infektosh me hepatit B?

Hepatiti B mund të transmetohet nga një person tek tjetri përmes gjakut, spermës dhe lëngjeve vaginale. Disa nga mënyrat e zakonshme të transmetimit të hepatitit B përfshijnë:

- Gjatë lindjes; një person shtatzënë që jeton me hepatit B mund t'ia transmetojë hepatitin B të porsalindurit.
- Kryerja e marrëdhënieve seksuale pa masa mbrojtëse fizike, si p.sh. prezervativë apo diga gome (dentare), me një person që jeton me hepatit B.
- Bashkëpërdorimi ose ripërdorimi i shiringave, pajisjeve mjekësore apo për injeksione, si ato për insulinë, monitoruesit e glukozës, përdorim droge, steroide, tatuazhe ose akupunkturë.
- Bashkëpërdorimi i mjeteve të kujdesit personal, si brisqet e rrojës, furçat e dhëmbëve apo artikujve të tjerë që mund të kenë qenë në kontakt me gjakun, spermën apo lëngjet vaginale.

Kontakti i rastësishëm është i sigurt

Njerëzit që jetojnë me hepatit B nuk duhet të përjashtohen nga punësimi, shkollimi, argëtimi apo shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve.

Hepatiti B nuk mund të përhapet përmes:

- Bashkëpërdorimit të enëve të ngrënies, gotave të pijeve, ushqimit ose ujit
- Teshtimave, kollës, puthjeve, përqaftimeve apo shtrëngimit të duarve



Fazat e hepatitit B

Hepatiti B akut është një infeksion i ri. Shumë të rritur që preken nga hepatiti B e luftojnë infeksionin pa trajtim brenda gjashtë muajve. Nëse e luftoni hepatitin B gjatë fazës akute, ju zhvillon imunitet, që do të thotë se jeni të mbrojtur nga infektimi me hepatit B. Personat me sistem të dobët imunitar, si foshnjat, fëmijët apo personat me HIV, kanë më pak gjasa ta luftojnë hepatitin B gjatë fazës akute të infeksionit.



Hepatiti B kronik është një infeksion i vazhdueshëm ose që zgjat gjithë jetën, i cili zhvillohet kur trupi nuk mund ta largojë virusin brenda gjashtë muajve. Shumica e personave që jetojnë me hepatit B kronik janë infektuar që kur ishin foshnja ose fëmijë të vegjël.

Simptomat e hepatitit B


Shenjat dhe simptomat e hepatitit B akut mund të përfshijnë ethe, lodhje, humbje oreksi, të përziera, të vjella, dhimbje barku, urinë me ngjyrë të errët, feçe në ngjyrë gri, dhimbje kyçesh ose verdhëz (zverdhje të lëkurës apo syve). Zakonisht këto simptoma largohen pas disa javësh.

Shumë persona që zhvillojnë hepatit B kronik nuk kanë simptoma për dekada me radhë dhe mund të mos e dinë se janë të infektuar, por mund gjithsesi të përhapin virusin. Shfaqja e simptomave është shpesh shenjë e sëmundjes së avancuar të mëlçisë, kur kjo e fundit nuk arrin më të kryejë funksionin e saj. Testimi është e vetmja mënyrë për të mësuar nëse jeni bartës i hepatitit B.



Si ndikon hepatiti B kronik në shëndet

Personat me hepatit B kronik mund të zhvillojnë dëmtim të rëndë të mëlçisë, duke përfshirë çikatrizim, fibrozë (dëmtim mesatar i mëlçisë) dhe cirrozë (dëmtim i rëndë i mëlçisë). Zakonisht dëmtimi i mëlçisë ndodh gradualisht, në harkun e 20 deri në 30 viteve. Personat që jetojnë me hepatit B kronik janë të ekspozuar ndaj rrezikut për kancer mëlçie në çdo fazë të sëmundjes dhe duhet të kontrollohen çdo gjashtë muaj për kancer mëlçie.



Testohuni: Mësoni gjendjen tuaj lidhur me hepatitin B

Kërkojini ofruesit tuaj të kujdesit shëndetësor që t'ju testojë për hepatit B nëse jeni të ekspozuar ndaj rrezikut.

A jeni të ekspozuar ndaj rrezikut për hepatit B?

Nëse përgjigjja e ndonjërës prej pyetjeve të mëposhtme është "po", duhet të testoheni për hepatit B:

- A ka qenë nëna juaj bartëse e hepatitit B në momentin e lindjes suaj?
- A keni lindur ju ose prindërit tuaj në një shtet me shkallë të lartë hepatiti B? (Shihni listën në faqen tjetër.)
- A jeton ndonjë prej partnerëve tuaj seksualë me hepatit B?
- A jeni një mashkull që kryen marrëdhënie seksuale me meshkuj?
- A bashkëjetoni me një person që jeton me hepatit B?
- A jetoni me HIV?
- A keni injektuar ndonjëherë droga ose keni bashkëpërdorur pajisje për përdorim droge (të tilla si shiringa, furnela, pambuk, pipëza apo ujë për shpëlarje)?



Vendet ku hepatiti B është i përhapur

Hepatiti B është mjaft i përhapur në vendet* e renditura më poshtë. **Nëse keni lindur në një nga vendet në këtë listë**, duhet të testoheni për hepatit B.**

RAJONI AFRIKAN

Të gjitha shtetet, përveç Sejsheleve.

RAJONI I AMERIKAVE

Belizë, Kolumbi, Republikë Dominikane, Ekuador, El Salvador, Guiana Franceze, Guatemalë, Haiti, Honduras, Xhamajkë, Peru, Porto-Riko, Surinami, disa zona të Brazilit, jugu i Kolumbisë, veriu i Bolivisë, popullsitë indigjene në Amerikën e Veriut

RAJONET E MESHDEUT LINDOR DHE AZISË JUGLINDORE

Bangladesh, Butani, Xhibuti, Palestinë (Rripi i Gazës), Indi, Kuvajt, Libi, Mianmar, Oman, Pakistan, Arabi Saudite, Somali, Sri-Lankë, Sudan, Siri, Tajlandë, Tunizi, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jemen

RAJONI EVROPIAN

Shqipëri, Azerbajxhan, Bjellorusi, Bullgari, Kroaci, Qipro, Gjeorgji, Itali, Kazakistan, Kosovë, Kirgistan, Moldavi, Rumani, Rusi, Serbi, Taxhikistan, Turqi, Uzbekistan

RAJONI I PAQËSORIT PERËNDIMOR

Brunei Darusalem, Kamboxhia, Kinë, Fixhi, Kiribati, Laos, Ishujt Marshall, Mikronezi, Mongoli, Nauru, Zelandë e Re, Niue, Palau, Guine e Re Papua, Filipine, Korea e Jugut, Samoa, Singapor, Ishujt Solomon, Tahiti, Tonga, Tuvalu, Vanuatu, Vietnam

* Shtete ku prevalenca (numri i personave të diagnostikuar rishtas dhe që jetojnë me hepatit B) e infeksionit të hepatitit B kronik është mbi 2%

** Rajone të Organizatës Botërore të Shëndetësisë

Të kuptuarit e rezultateve të testit të hepatitisit B

Ofruesi i kujdesit shëndetësor mund të kryejë disa nga këto analiza për të konfirmuar se keni hepatitis B.

	Testet			Interpretimi i rezultateve	Hapat e radhës
	Antigjeni sipërfaqësor i hepatitisit B (HBsAg)	Antitrupi sipërfaqësor i hepatitisit B (anti-HBs)	Antitrupi qendror i hepatitisit B (anti-HBc)		
Rezultatet	—	—	—	Mosprani ose imunitet ndaj infeksionit të hepatitisit B. I ekspozuar ndaj rrezikut për hepatit B.	Vaksinohuni.
	—	+	+	Me imunitet të zhvilluar në sajë të luftimit të infeksionit të hepatitisit B. Sigurohuni që ofruesi i kujdesit shëndetësor të dijë se e keni kaluar hepatitisin B në të kaluarën.	Nuk nevojitet vaksinë.
	—	+	—	Me imunitet të zhvilluar në sajë të përfundimit të serisë së vaksinimit kundër hepatitisit B.	Nuk nevojitet vaksinë.
	+	—	+	Jeton aktualisht me hepatit B.	Mërmirë kujdes shëndetësor nga një ofrues kujdesi shëndetësor për hepatitisin B. Nevojiten teste të tjera.
	—	—	+	Rezultate të paqarta – infektim i mundshëm në të kaluarën ose aktualisht.	Mërmirë kujdes shëndetësor nga një ofrues kujdesi shëndetësor për hepatitisin B. Nevojiten teste të tjera.

- do të thotë rezultat negativ testi

+ do të thotë rezultat pozitiv testi

Vaksinohuni: Mbroni veten dhe të tjerët

Nëse nuk keni hepatit B dhe nuk jeni imun, vaksinohuni për të parandaluar hepatitin B. Vaksina e hepatitit B bëhet në një seri prej dy ose tre dozash dhe është e sigurt dhe efikase.

Ju keni imunitet ndaj hepatitit B nëse:

- Jeni ekspozuar ndaj hepatitit B në të kaluarën, por trupi juaj e ka larguar virusin. Këtë mund ta mësoni vetëm duke kryer testin e hepatitit B.
- Jeni vaksinuar siç duhet. Kërkojini ofruesit të kujdesit shëndetësor që të verifikojë nëse vaksinimi ju ka bërë efekt.

Merrni kujdes dhe trajtim

Është e rëndësishme që të merrni kujdes mjekësor nga një ofrues kujdesi shëndetësor me përvojë me hepatitin B. Ofruesi i kujdesit shëndetësor mund të kryejë analiza të tjera për të parë se si ndikon hepatiti B në shëndetin tuaj, si p.sh:

- **Teste ADN-je për hepatitin B** për të kontrolluar sasinë e virusit të hepatitit B në gjak.
- **Teste të funksionit të mëlçisë** për të llogaritur masën e inflamacionit të mëlçisë.
- **Ekzaminim të mëlçisë me ultratinguj ose Fibroscan** për të kontrolluar për dëmtim të mëlçisë, duke përfshirë një imazh të formës, përmasave ose shtangësisë së mëlçisë.
- **Ekzaminim për kancer mëlçie** me anë të analizave të gjakut dhe ekzaminimeve me ultratinguj.



Për të rriturit që jetojnë me hepatit B, ekzaminimi për kancer mëlçie rekomandohet çdo gjashtë muaj.



Hepatiti B mund të jetë duke dëmtuar mëlçinë tuaj, edhe nëse ndiheni të shëndetshëm. Drejtohuni te një ofrues kujdesi shëndetësor me përvojë në trajtimin e hepatitit B për të kontrolluar shëndetin e mëlçisë dhe gjendjen tuaj lidhur me hepatitin B.

Konsultohuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor rreth trajtimit të hepatitit B

Barnat antivirale të hepatitit B mund të ngadalësojnë ose të ndalojnë dëmtimin e mëlçisë nga virusi.

Nëse po trajtoheni për hepatitin B, merrni barnat sipas rekomandimit, në mënyrë që të parandaloni dëmtimin e mëlçisë nga virusi. Mos e ndërpritni marrjen e barnave tuaja pa u konsultuar me ofruesin e kujdesit shëndetësor.

Bëjini ofruesit të kujdesit shëndetësor këto pyetje të rëndësishme rreth hapave të radhës dhe rreth të jetuarit me hepatit B:

- Sa është ngarkesa ime virale e ADN-së së hepatitit B?
- Sa të dëmtuar e kam mëlçinë?
- A më nevojitet trajtim antiviral për hepatitin B?
- A duhet të vaksinohem kundër hepatitit A për të mbrojtur shëndetin e mëlçisë?
- Çfarë duhet të bëj për të mbrojtur mëlçinë çdo ditë? Çfarë duhet të shmang?
- A është e sigurt marrja e barnave të mia të tjera, duke përfshirë barnat që jepen pa recetë, acetaminofenin (Tylenol), barnat bimore, vitaminat dhe suplementet?
- Si mund t'i mbroj nga hepatiti B personat me të cilët jetoj apo partnerët seksualë? Në ç'rast duhet të testohen dhe të vaksinohen ata?

Të jetuarit me hepatit B

Personat që jetojnë me hepatit B mund të kenë një jetë të gjatë dhe të shëndetshme. Këtu jepen disa mënyra se si mund të mbroni shëndetin tuaj.

Shmangni alkoolin.

Alkooli dëmton mëlçinë. Për shëndetin tuaj, është më e sigurt të mos pini fare alkool. Reduktimi është gjithashtu i dobishëm. Për mbështetje në reduktimin e konsumit të alkoolit, konsultohuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor ose lexoni seksionin "Informacione dhe burime" për të gjetur shërbime të tjera mbështetëse, duke përfshirë "NYC Well".

Konsultohuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor përpara se të merrni mjekime natyrore apo barna që jepen pa recetë.

Konsultohuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor përpara se të merrni barna që jepen pa recetë, barna bimore, vitamina apo suplemente, pasi ato mund të jenë të rrezikshme për mëlçinë. Këtu përfshihet acetaminofeni, hekuri, bimët mjekësore ose suplemente të tjera natyrore dhe vitamina. Tregojini ofruesit të kujdesit shëndetësor se keni hepatit B në mënyrë që të mund t'ju ndihmojë të shmangni barna që mund të dëmtojnë mëlçinë apo të përkeqësojnë hepatitin B.

Parandaloni dhjamosjen e mëlçisë dhe mbani nën kontroll sëmundjet kronike.

Dhjamosja e mëlçisë, një akumulim i yndyrës së tepërt në mëlçi, mund të shkaktojë dëmtim të mëlçisë. Konsumi i tepërt i alkoolit ose diabeti apo obeziteti mund të shkaktojnë dhjamosje të mëlçisë, gjë e cila mund të përkeqësojë hepatitin B. Konsultohuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor mbi mënyrat e parandalimit të dhjamosjes së mëlçisë dhe mbajtjes nën kontroll të sëmundjeve kronike.

Vaksinohuni kundër hepatitit A.

Hepatiti A është një tjetër virus që mund të dëmtojë mëlçinë tuaj. Personat që jetojnë me hepatit B mund të sëmuren më shpejt dhe më rëndë, apo të kenë sëmundje fatale, nëse infektohen nga hepatiti A.

Praktikoni reduktimin e dëmit dhe marrëdhënie më të sigurta seksuale.

Për të parandaluar ekspozimin ndaj gjakut, mos bashkëpërdorni ose ripërdorni pajisje mjekësore ose mjete të përdorimit të drogave, si dhe përdorni masa mbrojtëse fizike gjatë marrëdhënieve seksuale.

Merrni mbështetje

Ndani me ofruesin e kujdesit shëndetësor dhe personat tuaj të besuar ndjesitë tuaja lidhur me diagnostikimin me hepatit B.

Të jetuarit me hepatit B mund të mos jetë gjithmonë e thjeshtë, por bisedat me ofruesin e kujdesit shëndetësor dhe personat tuaj të besuar mund t'ju ndihmojnë të menaxhoni ndjenjat dhe të merrni mbështetjen që ju nevojitet. Merrni mbështetje në lidhje me të jetuarit me hepatit B duke telefonuar Fondacionin Amerikan për Problemet e Mëlçisë (American Liver Foundation) në numrin 800-465-4837. Për më shumë informacion, lexoni seksionin "Informacione dhe burime".



Për të mësuar rreth personave të tjerë që jetojnë me hepatit B dhe për t'i takuar ata, vizitoni hepb.org/research-and-programs/patient-story-telling-project.

Mbroni personat e tjerë nga hepatiti B

Duke qenë se mund t'ua transmetoni hepatitin B personave të tjerë, duhet t'i inkurajoni personat në familjen tuaj, personat me të cilët kryeni marrëdhënie seksuale dhe personat me të cilët ndani gjilpërat, pajisjet mjekësore ose ato për injeksion që të testohen dhe të vaksinohen kundër hepatitit B.

- Mos bashkëpërdorni ose ripërdorni pajisjet mjekësore. Sigurohuni që të përdoren gjithmonë pajisje të reja ose sterile për akupunkturë, tatuazhe ose injeksione (për shembull, gjilpëra për insulinë, steroide ose barna).
- Mos bashkëpërdorni ose ripërdorni mjetet e përdorimit të drogave. Përdorni vetëm pajisje të reja ose sterile ose mjete të tilla si gjilpëra, shiringa, pambuk, filxhanë, zhgut, brisqe, prerës, ujë për shpëlarje, furnelë, pipëza ose tuba.
- Përdorni masa mbrojtëse fizike, si prezervativë ose diga gome (dentare), gjatë marrëdhënieve seksuale derisa partneri juaj të jetë plotësisht i vaksinuar dhe imunizuar ndaj hepatitit B.
- Mos bashkëpërdorni mjetet e kujdesit personal, si gjilpërat, brisqet e rrojës, furçat e dhëmbëve apo artikuj të tjerë që mund të kenë qenë në kontakt me gjakun, spermën apo lëngjet vaginale.
- Mbuloni të prerat dhe plagët e hapura me garza dhe sigurohuni që personat e tjerë të mos e prekin gjakun tuaj.
- Lajini mirë duart pasi të keni prekur gjakun ose lëngjet tuaja trupore, si sperma ose lëngjet vaginale.
- Pastrojini rrjedhjet e gjakut me një solucion zbardhues të përbërë nga një porcion zbardhuesi dhe nëntë porcione ujë.

Nëse ju apo një person i njohur jeni ekspozuar së fundi ndaj hepatitit B, kryeni profilaksinë pas ekspozimit për hepatitin B.

Telefononi menjëherë ofruesin e kujdesit shëndetësor dhe informohuni rreth imunoglobulinës për hepatitin B, një mjekim që mund të ndihmojë në ndalimin e përhapjes së virusit në trup. Në mënyrë që të jetë efikase, ajo duhet të administrohet brenda shtatë ditëve pas ekspozimit.



Shtatzënia, fëmijët dhe hepatiti B

Shtatzënia dhe hepatiti B

Të gjithë personat shtatzënë duhet të testohen për hepatitin B në çdo shtatzëni. Nëse jeni shtatzënë dhe jetoni me hepatit B, flisni me ofruesin e kujdesit shëndetësor rreth mënyrave të parandalimit të transmetimit të hepatitit B te fëmija juaj gjatë lindjes.

Për të parandaluar hepatitin B, foshnja juaj duhet të marrë një dozë të vaksinës së hepatitit B (doza në lindje) dhe një dozë imunoglobuline për hepatitin B menjëherë pas lindjes, jo më vonë se 12 orë më pas. Sigurohuni që ta përfshini këtë në planin tuaj të lindjes.

I porsalinduri juaj do të duhet ta përfundojë serinë e vaksinave kundër hepatitit B brenda nëntë muajve të parë të jetës. Pas përfundimit të serisë së vaksinave kundër hepatitit B, fëmijët duhet të testohen për hepatit B për t'u siguruar se kanë zhvilluar imunitet. Testimi nuk duhet të kryhet para moshës 9-muajshe.

Kërkojini ofruesit të kujdesit shëndetësor që t'ju bëjë kontrole të rregullta të gjendjes lidhur me hepatitin B dhe të shëndetit të mëlçisë, gjatë shtatzënisë dhe pas lindjes.



Nëse ju nevojitet ndihmë apo mbështetje për ushqyerjen me gji apo për ushqimin, flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor ose atë të të porsalindurit tuaj. Gjithashtu, mund të vizitoni wicstrong.com ose të telefononi linjën telefonike "Të rritemi të shëndetshëm" (Growing Up Healthy Hotline) në numrin 800-522-5006.

Hepatiti B nuk transmetohet me anë të qumështit të gjirit, përveç rasteve kur ka prani gjaku. Mos ndani ushqim që e keni pasur në gojën tuaj. Mos e përtpyni vetë paraprakisht ushqimin për bebet.



Konsultohuni me ofruesin e kujdesit shëndetësor nëse jeni shtatzënë apo duke ushqyer me gji dhe keni pyetje rreth marrjes së barnave antivirale për hepatitin B. Mos e ndërpritni marrjen e barnave pa u konsultuar me ofruesin e kujdesit shëndetësor.

Fëmijët dhe hepatiti B

Vaksinimi është mënyra më e mirë për parandalimin e hepatitit B. Të gjithë fëmijët duhet të përfundojnë serinë e vaksinave kundër hepatitit B dhe të testohen për t'u siguruar se kanë zhvilluar imunitet. Nëse fëmija juaj ka hepatit B, është e rëndësishme të merrni kujdes shëndetësor nga një ofrues kujdesi shëndetësor me përvojë lidhur me hepatitin B.

Nëse fëmija juaj ka hepatit B, nuk është e nevojshme t'u tregoni mësuesve, ofruesve të kujdesit ditor, fëmijëve të tjerë apo prindërve të tyre. Të gjithë duhet të marrin masa paraprake të përgjithshme për të parandaluar përhapjen e sëmundjes infektive.

Informacione dhe burime

Gjeni më shumë informacion rreth hepatitit B.

Departamenti i Shëndetit dhe i Higjienës Mendore i Qytetit të Nju-Jorkut (NYC Department of Health and Mental Hygiene)

Telefononi në numrin **311** dhe pyesni për hepatitin B ose vizitoni **nyc.gov/health/hepb**.

Fondacioni për Hepatitin B (Hepatitis B Foundation)

Telefononi në numrin 215-489-4900 ose vizitoni hepb.org. Informacioni disponohet në disa gjuhë.

Fondacioni Amerikan për Problemet e Mëlçisë (American Liver Foundation)

Telefononi 800-465-4837 ose vizitoni liverfoundation.org.

Qendrat për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve

Vizitoni cdc.gov/knowhepatitisb. Informacioni disponohet në disa gjuhë.

**Gjeni shërbime të përballeshme kujdesi shëndetësor për hepatitin B pranë jush
Departamenti i Shëndetit i Qytetit të Nju-Jorkut (NYC Health Department)**

Vizitoni **nyc.gov/health/hepb**.

Gjeni shërbime kujdesi mjekësor me kosto të ulët për hepatitin B në spitalet publike të qytetit të Nju-Jorkut

Vizitoni **nyc.gov/health/map**.

"NYC Well"

"NYC Well" është një linjë telefonike pa pagesë dhe konfidenciale për mbështetjen për shëndetin mendor dhe përdorimin e substancave. Ajo është në dispozicion 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, në mbi 200 gjuhë.

- Telefononi 888-692-9355.
- Dërgoni mesazh me tekst "WELL" në numrin 65173.
- Vizitoni nyc.gov/nycwell.

Gjeni sigurim shëndetësor

Për të folur falas me një konsulent rreth mënyrës së regjistrimit për sigurim shëndetësor me kosto të ulët ose pa kosto, vizitoni nyc.gov/health dhe kërkoni "përfito mbulim" (get covered), dërgoni mesazh me tekst "CoveredNYC" në numrin 877-877 ose telefononi numrin **311**.

Gjeni përfitime dhe programe të tjera

Për të gjetur shërbime të tjera, vizitoni access.nyc.gov. Informacioni disponohet në disa gjuhë.

Koalicioni i Komunitetit të Hepatitit B (Hep B Community Coalition)

Për të mësuar më shumë rreth koalicionit të komunitetit të Departamentit të Shëndetit të Qytetit të Nju-Jorkut (NYC Health Department), vizitoni hepfree.nyc.



